

V E N D I M
Nr. 401, datë 22.8.2002

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, ME
NDRYSHIMET PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, me ndryshimet përkatëse të bëhen këto shtesa:

1. Në lidhjen nr. 1 “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” shtohen këto emërtime:
 - Në klasifikimin A7 “Sekretar i Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme”.
 - Në klasifikimin A10 “Shef i Kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm”

LIDHJA II-32
NIVELI I PAGËS PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS
SË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi
1.	Sekretar i Përgjithshëm	A7
2.	Shef Kabineti	A10
3.	Këshilltar, drejtor drejtorie	A12
4.	Përgjegjës sektori	B4
5.	Zëdhënës shtypi, inspektor kontrolli, përkthyes, përgjegjës zyre	B5
6.	Specialist, jurist, sekretar i Prokurorit të Përgjithshëm	C2

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi
1.	Oficer informacioni dhe i ruajtjes së rendit	VIII
2.	Teknik mirëmbajtjeje, operator, magazinier, arkëtar	VII
3.	Shofer, punonjës shërbimi	V
4.	Punëtore pastrimi	III

- Në klasifikimin A12 “Këshilltar i Prokurorit të Përgjithshëm, drejtor drejtorie në Prokurorinë e Përgjithshme”.

- Në klasifikimin B4 “Përgjegjës sektori në Prokurorinë e Përgjithshme”.

- Në klasifikimin B5 “Zëdhënës i Prokurorit të Përgjithshëm”; në Prokurorinë e Përgjithshme”; Inspektor kontrolli në Prokurorinë e Përgjithshme; “Përkthyes në Prokurorinë e Përgjithshme”.

- Në klasifikimin C2 “Specialist jurist në Prokurorinë e Përgjithshme”, “Sekretar i Prokurorit të Përgjithshëm”.

2. Shtohet lidhja II-32 dhe II-M “Niveli i pagës për punonjësit e administratës së Prokurorisë së Përgjithshme”, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2002, miratuar për Prokurorinë e Përgjithshme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht 2002.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano